



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2422, datë 19.02.2014

Për

“Miratimin e Formularëve të Regjistrimit për përdoruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike, si pjesë e dokumentit, Rregulla për “Termat e Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit për Lidhjen dhe Aksesin në Rrjetin Publik të Komunikimeve Elektronike”, miratuar me Vendimin nr. 2405, datë 26.12.2013 të Këshillit Drejtues të AKEP.

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

- | | | | |
|---------|--------|------------|---------|
| 1. Z. | Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. | Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. | Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. | Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. | Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Iris Xhanaj, në mbledhjen e datës 19.02.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, mori në shqyrtim çështjen me objekt:

“Miratimin e Formularëve të Regjistrimit për përdoruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike, si pjesë e dokumentit, Rregulla për “Termat e Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit për Lidhjen dhe Aksesin në Rrjetin Publik të Komunikimeve Elektronike”, miratuar me Vendimin nr. 2405, datë 26.12.2013 të Këshillit Drejtues të AKEP.”

B A Z A L I G J O R E:

1. Neni 98, 99, 100, 101, 101/1,114 dhe 115 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918, i ndryshuar*);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*ligji nr. 8485, i ndryshuar*);

3. Ligji nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
4. Vendim nr. 2405, datë 26.12.2013 i Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentit me Rregulla për “Termat e Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit për Lidhjen dhe Aksesin në Rrjetin Publik të Komunikimeve Elektronike” (*Vendimi nr. 2405*),

K Ë SH I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

1. Relacioni shpjegues mbi Formularët e Regjistrimit, si pjesë e dokumentit, Rregulla për “Termat e Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit për Lidhjen dhe Aksesin në Rrjetin Publik të Komunikimeve Elektronike”, miratuar me Vendimin nr. 2405, datë 26.12.2013 të Këshillit Drejtues të AKEP.;
2. Projektvendimi i Këshillit Drejtues i formatuar dhe arsyetuar;
3. si dhe diskutimeve në mbledhje mbi çështjen duke i’u referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N se:

1. Formularët e regjistrimit me të dhënat, të cilat janë të detyrueshme të jepen nga përdoruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike, për shërbimin publik telefonik të lëvizshëm dhe të qëndrueshëm, janë miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 327, datë 14.12.2006:
2. Në kuadër të pasqyrimin të ndryshimeve të ndodhura si pasojë e nenit 100 të Ligjit nr. 9918, si dhe të VKM nr.1, datë 07.01.2009, me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr.736, datë 03.03.2009, “Mbi dokumentacionin e detyrueshëm për regjistrimin e pajtimtarëve”, është përcaktuar dokumentacioni për kryerjen e regjistrimit të përdoruesve të shërbimit publik telefonik të lëvizshëm dhe të qëndrueshëm.
3. Formularët e regjistrimit për përdoruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike, në veçanti për Shërbimin Publik Telefonik të Lëvizshëm, Shërbimin Publik Telefonik të Qëndrueshëm dhe atë të Akses Internetit, janë publikuar së bashku me dokumentin rregullator, Rregulla për “Termat e Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit për Lidhjen dhe Aksesin në Rrjetin Publik të Komunikimeve Elektronike” për këshillim publik në faqen e internetit, me Vendimin nr. 2343, datë 20.08.2013, mbi të cilat nuk janë paraqitur komente.
4. Ndryshimet e ligjit nr.9918, të cilat rritin detyrimin e sipërmarrësve në lidhje me ruajtjen dhe administrimin e të dhënave personale, si dhe nevoja për të saktësuar më mirë detyrimet e pajtimtarit dhe sipërmarrësit në procesin e deklarimit dhe regjistrimit të të dhënave të pajtimtarit, bënë të nevojshme rishikimin e formularëve të regjistrimit, në veçanti atë të shërbimit publik telefonik të lëvizshëm, duke i plotësuar ato me elementë të tjerë, me qëllimin e rritjes së efektivitetit të të dhënave që përmbajnë.

5. Formularët e regjistrimit të hartuar për përdoruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke marrë në konsideratë funksionin e tyre, duhet të jenë pjesë e dokumentit, Rregulla për “Termat e Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit për Lidhjen dhe Aksesin në Rrjetin Publik të Komunikimeve Elektronike”, miratuar me Vendimin nr. 2405, datë 26.12.2013 të Këshillit Drejtues të AKEP.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues, duke konsideruar rëndësinë e miratimit të formularëve të regjistrimit, për Shërbimin Publik Telefonik të Lëvizshëm, Shërbimin Publik Telefonik të Qëndrueshëm, dhe atë të Akses Internetit, në përmbushje të detyrimeve ligjore, bazuar në nenin 114 dhe 115 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Kodit të Procedurave Administrative,

V E N D O S:

1. Të miratojë Formularët e Regjistrimit për Shërbimin Publik Telefonik të Lëvizshëm, Shërbimin Publik Telefonik të Qëndrueshëm dhe atë të Akses Internetit, sipas dokumentave bashkëlidhur;
2. Formularët e miratuar të bëhen pjesë e dokumentit, Rregulla për “Termat e Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit për Lidhjen dhe Aksesin në Rrjetin Publik të Komunikimeve Elektronike”, miratuar me Vendimin nr. 2405, datë 26.12.2013 të Këshillit Drejtues të AKEP.
3. Regjistrimi i pajtimtarëve nga sipërmarrësit sipas formularëve të miratuar me këtë Vendim të fillojë nga data 1.04.2014.
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al
Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**